



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 269, Datë 21.12.2018

MBI

**LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 97, DATË 23.4.2018
“MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA
SHOQËRIA “ALBGAZ” SH.A. PËR VITIN 2018, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 13 pika 1, pika 2, neni 17 pika 1, gërma “e” dhe nenit 33 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, nenit 15 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 21.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve në lidhje me lënien në fuqi, të Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.4.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a. për vitin 2018”, i ndryshuar

Konstatoi se :

- Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 97, datë 23.04.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a. për vitin 2018. vendosi miratimin e tarifës të transmetimit të gazit natyror për shoqërinë “ALBGAZ” sh.a. për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018.
- Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. nuk ka paraqitur aplikim për rishikimin e tarifës së transmetimit për periudhën pasardhëse rregullatore të vitit 2019, në përputhje me “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit për Gazin Natyror”.
- Mungesa e vlerës së investimeve për vitin 2019, si komponent i rëndësishëm i llogaritjes së tarifës dhe që pritet të paraqitet në vitin pasardhës, bën të pamundur llogaritjen e të ardhurave të kërkuara dhe përcaktimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror për vitin 2019.
- Tarifa e aktivitetit të transmetimit është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit nga Shoqëria “ALBGAZ” sh.a., aktivitet ky që ushtrohet konform Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe direktivave të Bashkimit Europian. Aksesit në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet të i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE.
- Në këto kushte është e domosdoshme lënia në fuqi e Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.04.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria

“Albgaz” sh.a., për vitin 2018, i ndryshuar i cili vendosi: Miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a, për vitin 2018 prej 28 Lekë/m³ ose 2.6457 Lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të shtyjë fuqinë juridike të Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.04.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2018”, i ndryshuar deri më datë 31.03.2019.
2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 17, pika “e” të Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë Albgaz sha për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI